

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Dhjetor 2025

Tiranë, më 23 Janar 2026: Gjatë muajit Dhjetor 2025, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 1.542.889 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 7,0 %, krahasuar me Dhjetor 2024.


1.353.137 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 8,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve

Në Dhjetor 2025, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 844.147, duke pësuar një rritje me 7,1 %, krahasuar me Dhjetor 2024.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 698.742. Ky numër është rritur me 6,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (fig.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Dhjetor 2024 - Dhjetor 2025



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Për publikim 23/01/2026

Daljet e shtetasve

Në muajin Dhjetor 2025, 714.457 shtetas shqiptarë numërohen të kenë dalë nga territori i Shqipërisë, duke shënuar rritje me 10,6 %, krahasuar me Dhjetor 2024.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Dhjetor 2025 janë 638.680. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues është rritur me 5,5 % (tab.1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Dhjetor 2024	Janar - Dhjetor 2025	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	1.442.193	1.542.889	7,0	19.703.020	20.996.934	6,6
Shqiptarë	787.851	844.147	7,1	8.006.909	8.530.896	6,5
Të Huaj	654.342	698.742	6,8	11.696.111	12.466.038	6,6
Dalje Gjithsej	1.251.392	1.353.137	8,1	19.321.700	20.929.830	8,3
Shqiptarë	646.178	714.457	10,6	7.878.384	8.589.343	9,0
Të Huaj	605.214	638.680	5,5	11.443.316	12.340.487	7,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Dhjetor 2025, 97 % e hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri janë nga rajoni i Evropës.

Evropa Jugore zë 85 % të hyrjeve të shtetasve të huaj nga kontinenti Evropian, ndjekur nga Evropa Perëndimore me 6 % dhe Evropa Veriore me 4 % (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025	Janar -Dhjetor 2024	Janar -Dhjetor 2025
Gjithsej	654.342	698.742	11.696.111	12.466.038
I . Afrika	1.385	1.559	31.466	44.736
II. Amerika	11.338	12.191	306.116	337.482
III. Azia Lindore dhe Paqësori	3.848	3.641	95.991	104.428
IV.Lindja e Mesme	1.001	1.222	30.156	34.810
V. Azia e Jugut	2.025	2.328	29.845	44.837
VI. Evropa	634.235	677.259	11.146.979	11.888.574
- Evropa Qëndrore / Lindore	20.981	22.786	850.679	867.229
- Evropa Veriore	22.383	23.859	491.694	534.624
- Evropa Jugore	533.415	576.808	8.468.557	8.919.296
- Evropa Perëndimore	41.657	40.902	990.143	1.183.377
- Evropa Lindore / Mesdheut	15.799	12.904	345.906	384.048
VII. Rajone të paspecifikuara	510	542	55.558	11.171

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Qëllimi i hyrjes në territorin shqiptar i shtetasve të huaj, në 97 % të rasteve është për qëllime personale. Në Dhjetor 2025, ky tregues ka shënuar një rritje me 6,6 %, krahasuar me Dhjetor 2024. Hyrjet e shtetasve të huaj, për qëllime biznesi dhe profesionale janë rritur me 13,0 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Dhjetor 2024	Janar - Dhjetor 2025	Ndryshimi në %
Hyrje shtetas të huaj	654.342	698.742	6,8	11.696.111	12.466.038	6,6
I. Personale	636.759	678.876	6,6	11.484.245	12.219.450	6,4
1. Pushime, vizitë tek të afërm. etj.	611.591	644.786	5,4	11.079.872	11.614.932	4,8
2. Trajtime shëndetësore	14	12	-14,3	637	375	-41,1
3. Qëllime fetare	9	19	111,1	360	428	18,9
4. Udhëtarë transit	25.145	34.059	35,5	403.376	603.715	49,7
II. Biznes dhe profesionale	17.583	19.866	13,0	211.866	246.588	16,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person, që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti, llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person, që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti, llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi i vazhdueshëm. Për më shumë informacion referojuni:

https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”. neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuark në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtare, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e shqiptarëve, të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.